



Historia e infermieres Sentijana Marku nga fshati Naraç, bashkia Vau i Dejës që paralelisht ka zgjedhur të merret...

Faqe 10



2500-60 mijë euro grante për peshkatarët - Aplikimet deri në fund të muajit. Fondi 720 mijë euro

Faqe 4



FAO: Kostot e plehrave e fertilizuesve mund të zgjasin tensionet globale të ushqimit!

Faqe 5



AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit qershor 2022

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 440
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

AKADEMIKËT, PROFESORËT DHE EKSPERTËT DISKUTOJNË PËR PRODHIMET BIO

FORUMI PËR BUJQËSINË ORGANIKE, PROF. DR. SHABAN SINANI: ME RËNDËSI SHKENCORE DHE NJË PREOKUPIM MBARËQYTETAR

Zhvillon punimet në Tiranë, në Akademinë e Shkencave forumi shkencor për Bujqësinë Organike, një sfidë, por edhe një mbështetje e rëndësishme për agroturizmin dhe zhvillimin rural në Shqipëri organizuar në bashkëpunim me Këshillin e Agrobiznesit Shqiptar, Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Sfidat e angazhimit në punë të grave, vajzave

Për të lehtësuar tranzicionin nga bankat e shkollës drejt tregut të punës për të rinjtë, përmes ofrimit të shërbimeve të përmirësuara të tregut të punës, projekti RisiAlbania po bashkëpunon me institucione që ndërmjetësojnë mes punëkërkuarit dhe punëdhënësit...



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2



"Ballkani i Hapur", Krifca: Volumi tregtar mes 3 vendeve u rrit në 79 milionë euro



Faqe 4

FAO

GFCM prezanton MedSea4Fish, një program ambicioz peshkimi për të vazhduar kthesën ndaj mbishfrytëzimit në Detin Mesdhe



Faqe 7

HISTORIK

Një Bord Ushqimi për të frenuar abuzimet me çmimet në Shqipërinë e 1934! Krijimi i Karteleve të Miellit dhe paralajmërimi për 'krizën klimatike'

Nga: Kreshnik Kuçaj

Faqe 7

AKTUALITET

Lufta në Ukrainë, fermerët shqiptarë rikthehen tek mbjellja e drithërave

Faqe 5




KENDI I EKSPERTIT

- Këshilla për fermerët që kultivojnë bimët aromatike mjekësore (bam) - qershor 2022 (QTTB Shkodër) Fq. 11
- Aspekte të ushqyerit të species së derit (QTTB Fushë Krujë) Fq. 12
- Kalendari bujqësor, muaji korrik 2022 - Nga: Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq. 13

RISI ALBANIA

Sfidat e angazhimit në punë të grave, vajzave

këtë lloj shërbimi është karakterizuar krahas qëllimit për të hyrë në brendinë e psikologjisë së studentit, vajzave e grave për të balancuar brenda tyre, çfarë dëshirojnë dhe çfarë mundet.



Ekspertët e Këshillimit të Karrierës drejtojnë dhe mbështesin në mënyrë të vazhdueshme Këshillin grave dhe vajzave, që janë një hallkë e rëndësishme në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit.

Duke u ndalur specifikisht në target grupin e grave dhe vajzave.

Çarku shpjegon se, sot kontrolli në rritje i grave mbi vendimet që prekin jetën e tyre pranohen gjerësisht si thelbësore për luftimin e varfërisë.

Sipas saj, investimi tek gratë ka treguar të ketë efekte të rëndësishme zhvillimore, pasi gratë shpenzojnë të ardhura shtesë për shëndetin dhe mirëqenien e familjeve

të tyre. Megjithatë, në të dy nivelet makro dhe mikro, pjesëmarrja ekonomike e grave pengohet nga barrierat strukturore dhe kulturore.

Ekspertët vlerësojnë se, disa nga çështjet kryesore që kufizojnë pjesëmarrjen ekonomike të grave përfshijnë: Pabarazitë në pronësinë e aseteve; Qëndrimet dhe normat sociale; Disbalancat e tregut të punës; Aksesi në shërbime financiare dhe tregje etj.

Këshillimi i karrierës mbështetet nga Projekti Risi-Albania (financuar nga SDC, në partneritet me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe zbatuar nga një konsorcium i përbërë nga HELVETAS S wiss Intercooperation dhe Partners Albania) Nga Projekti Arsim në Punësim (financuar nga SDC, zbatuar nga NIRAS IP Consult).

Përballja me ndryshimet klimatike

Shqipëria ndër vendet e rrezikuara, por me mundësi zhvillimi nëse përmirësohen në kohë shërbimet kryesore

Deklaratë për shtyp

Tiranë, 22 Qershor 2022

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës, së bashku me Helvetas dhe Agjencinë Zvic-

ezikuara nga ngrohja globale, por u ndal dhe në mundësitë që ka Shqipëria dhe sektori privat nëse ndërmarrin hapat e

me përmirësimin e shërbimeve të agroturizmit, të menaxhimit të mbetjeve. Duhet të jepen informacione të shpejta dhe të vazhdueshme të fermerët, tek punonjësit të sektorit të turizmit, pasi kjo është një mundësi e mirë edhe për t'u zhvilluar."-shprehet znj. Mukerji.

Gjatë seminarit u prezantuan studime nga academia, si dhe veprimet dhe masat e ndërmarra nga aktorë publikë dhe privatë në menaxhimin e mbetjeve. Por pavarësisht kësaj, niveli i ndërgjegjësimit mbetet i ulët. Kjo për shkak edhe se kompleksiteti i temës është i lartë.

Bazuar në raportin e gjashtë të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC) diskutimi u fokusua më tej

duhura.

"Shqipëria është një ndër



erane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, organizuan ditën e djeshme seminarin dedikuar Ndryshimeve Klimatike, me të ftuar kryesore Rupa Mukerji, eksperte ndërkombëtare dhe bashkautore e raportit të gjashtë të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC).

Ky seminar ishte një hapësirë diskutimesh me aktorë të ndryshëm, nga sektori privat, academia dhe përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si edhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ndërlidhja dhe bërja bashkë e këtyre aktorëve përmes këtij seminary synon të nxisë diskutimin publik dhe ndërgjegjësimin lidhur me temën, duke u bazuar në raportin e IPCC.

Rupa Mukerji, bashkautore e studimit, tregon se Shqipëria është një ndër vendet më të rre-



vendet më të rrezikuara krahasuar me vende të tjera në Europë. Ka rreziqe si tërheqja e detit, dalja e lumenjve nga shtrati dhe rritje të temperaturave. Të gjitha këto kanë ndikim të madh në mjedis.

Shqipëria duhet të punojë

dhe në mënyrat se si gjetjet kryesore mund të çojnë në më shumë ndërgjegjësim, të nxisin veprime, por edhe se si shkencë klimatike mund të trajtojë më tej punën dhe politikën për klimën dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Angazhimi me ndryshimet klimatike, Baza shkencore përshtatje - zbutje

Takimi mbi Ndryshimet Klimatike që u zhvillua në Tiranë, është pjesë e procesit të përfshirjes së aktorëve të biznesit dhe politikëbërësve në kuadër të ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit në kushtet e ndryshimeve klimatike.

Ndryshimet Klimatike, i paraparë si eveniment në ambientet e Universitetit Politeknik, i dha mundësi studentëve, të angazhohen në dialog me hartuesit e politikave dhe përfaqësuesit e biznesit, të shkëmbejnë ide dhe të ndërlidhen me qindra të rinj të tjerë të pasionuar për mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike. Evenimenti në fjalë ishte mundësi për të rinjtë, që ta shprehin zërin e tyre dhe ta ofrojnë pjesën e tyre integrale të sfidave për të ardhmen mbi Ndryshimet Klimatike. Takimi përcolli mesazhe të forta mbi Ndryshimet Klimatike, që reflektojnë perceptimet dhe qëndrimet e të rinjve, biznesit dhe politikëbërësve mbi ndryshimet klimatike, që do t'u komunikohet institucioneve të linjës për reflektime në të ardhmen e afërt.

Disa Pika nga Agjenda e takimit

Në Universitetin Politeknik u zhvillua workshop me temë Angazhimi me ndryshimet klimatike

Baza shkencore përshtatje - zbutje

Moderatorët e këtij takimi të rëndësishëm ishin Helvetas Albania, Valbona Karakaçi, Stefan Joss. Ndërsa një fjalë rasti mbajti Oltion Marko, Shefi Departamentit

të Inxhinierisë Mjedisore të PTU.

Ndër temat kryesore të kësaj konference ishin: Ndihma për zgjidhje të ndryshimeve klimatike, prezantimi i ndryshimeve dhe puna e ekipit kërkimor shkencor IPCC6, për të cilën foli Rupa Mukerji, Drejtor në Shërbimet Këshillimore Helvetas, Zvicër.

Më pas takimi vijoi me çështjen mbi monitorimin e ndryshimit të Strategjisë

ballë çështjes së ndryshimeve klimatike.

Në këtë aktivitet të rëndësishëm morën pjesë dhe përfaqësues të biznesit privat që me nismat e tyre në biznes po investojnë në përmirësimin e paketimit të perimeve për eksport, rasti PikIndustries, Lushnja.

Gjithashtu risitë drejt një modeli për riciklimin e mbetjeve organike të kafshëve i përcolli përfaqësuesi i Albanian Food industries,



Kombëtare Shqiptare mbi Klimën 2019-2030, "Metodologjia dhe gjendja e artit", për të cilën referoi Mihallaq Qirjo, Drejtor, Qendra e Burimeve Mjedisore.

Ndërsa Veruska Mucione, Universiteti i Zurihut, u ndal në temën "Ndryshimet klimatike - sfidat/mundësitë për BE dhe Shqipërinë".

Takimi vijoi me prezantimin e ndryshimeve klimatike, mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve, sfidat e tanishme të Shqipërisë, teksa vend të rëndësishëm zuri pasqyrimi (qasja ndaj partnerëve të ndryshëm, mundësi dhe vështirësi) për-

Lushnja, Alban Zusi.

Ndër të tjera takimi vijoi me çështjen e trajtimit të mbetjeve në landfille - Agron Ceka (Vau i Dejës Landfill); Riciklimi dhe mbetjet e rrezikshme, zgjidhjet publike-private - Kompania CEO VALE; Perceptimi publik dhe kuadri ligjor për ndalimin e plastikës - Redi Baduni, nga Ministria e Mjedisit.

Takimi pati jehonë të gjerë bashkëbisedimi me pyetje përgjigje dhe komente të cilat u ndoqën me interes nga të pranishmit dhe media që e pasqyroi këtë takim.

INFORMACIONE

“Ballkani i Hapur”, Krifca: Volumi tregtar mes 3 vendeve u rrit në 79 milionë euro

Hapja tregtare nën nismën “Ballkanit i Hapur” ka gjeneruar mundësi për rritjen e volumit tregtar mes Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca tha se, “eksportet bujqësore shqiptare drejt Serbisë

iut eksportet bujqësore “Made in Albania”, u rritën me 30% po për të njëjtën periudhë”.

“Në total kemi një rritje të volumit tregtar ndërmjet 3 vendeve nga 53,4 milionë euro në 79 milionë euro, për 5-mujorin e parë të vitit 2022 krahasuar me vitin 2021”, tha Krifca

parë këtij viti.

“Krahasuar me 5-mujorin e parë 2021, Shqipëria ka eksportuar 41 milionë euro më shumë në 5 mujorin 2022. Qeveria po mbështet me subvencione të drejtpërdrejta fermerin duke nxitur rritjen e prodhimit vendas. Sektori i njërit rritje të numrit të pikave të grumbullimit në 178 të tilla që janë një mbështetje produktive për trendin në rritje dhe zhvillim që shënon bujqësia sot”, deklaroi ministrja.

Duke folur për marrëveshjen e “Ballkanit të Hapur” dhe efektet e tjera që kjo marrëveshje ka në bujqësinë shqiptare, Krifca u shpreh se, “ato janë marrëveshje reciproke mes tre vendeve, që bëjnë pjesë në “Ballkanit e Hapur” dhe sigurojnë mbrojtjen e konsumatorëve në vendet përkatëse nga përhapja e sëmundjeve të bimëve dhe kafshëve bujqësore, duke njohur certifikatat fitosanitare veterinarë të secilit vend, duke njohur laboratorët apo testet që çojnë në uljen e kostove dhe të qëndrimit në pikat e kalimit kufitar dhe nxitjen e tregtisë”.



janë rritur në vlerë me rreth 100.17% gjatë 5-mujorit të parë të këtij viti, krahasuar me të njëjtën periudhë vitin e kaluar, kur nuk i kishim këto lehtësi që ofron “Ballkani i Hapur”. Ndërsa me Maqedoninë e Ver-

për ATSH-në.

Sipas saj, rritja eksporteve bujqësore shqiptare me vendet e Ballkanit të Hapur, është në të njëjtën linjë me rritjen në total që ka shënuar prodhimi ynë bujqësor gjatë 5-mujorit të

Krifca: Mbi 50% e prodhimit vendas të gështenjave eksportohet

Për të tretin vit radhazi, gështenja e Malësisë së Madhe do të jetë më e mbrojtur

Ministrja e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, Frida Krifca në një takim me fermerët që kultivojnë gështenja në zonën e Reçit në Malësinë e Madhe, njoftoi nisjen e luftës biologjike kundër parazitit të identifikuar në kulturën e gështenjës.

Ministrja tha se, tanimë ky investim i qeverisë ka dhënë rezultate konkrete në rritjen e prodhimit, ku vetëm për këtë zonë, nga 50 tonë prodhim në vit, tashmë sasia që fermerët kultivojnë është rritur në 250 tonë gështenja në vit.

“Kultura e gështenjës është një aset i rëndësishëm i sektorit të bujqësisë dhe se qëllimi i qeverisë është rritja e prodhimit dhe rritja e të ardhurave të fermerëve që punojnë me këtë produkt. Janë rreth 450 ha sipërfaqe, ku do të zhvillohet kjo luftë biologjike, nëpërmjet së cilës synohet rritja e rendimentit të prodhimit në zonën e Reçit. Ndërsa dezinfektimi do të kryhet këtë vit edhe në zo-

nën e Shalës, në një sipërfaqe tjetër prej rreth 150 ha”, bëri të ditur Krifca.

Ministrja vuri në dukje se, qeveria do të vijojë me zba-

mbrojtëse.

Gështenjat e vendit tonë dhe mjalti që prodhohet prej tyre njihen për vlerat e rralla kurative dhe kërkesat e larta



timin e këtij projekti, në mënyrë që t'i shërbejmë prodhimit të gështenjës, pasi mbi 50 % e prodhimit vendas eksportohet në tregjet ndërkombëtare me çmime konkurruese.

Mbrojtja e gështenjës nga insektet është direktivë e Komitetit Evropian që detyron çdo vend të marrë masat

nga tregu brenda e jashtë vendit, kanë shtuar të ardhurat e familjeve në zonat më veriore të vendit. Eksportet e gështenjave “Made in Albania” rriten çdo vit, duke gjeneruar miliona euro të ardhura në ekonominë e vendit. Pjesa më e madhe e prodhimit eksportohet në Itali, ku dhe përpunohet.

Protestë për çmimin e qershisë, fermerët e Dvoranit: Kostot rriten, çmimet ulen

Dvorani është një ndër prodhuesit kryesorë të qershisë e cila këtë vit në treg shitet me një çmim tepër të lartë

Prodhuesit e saj kanë protestuar pasi thonë se kostot janë rritur ndërsa ata shesin me çmime tepër të ulëta ndaj qershisë ka ngelur ende pa u vjelë në pemë.

Janë disa faktorë që kanë sjellë një situatë të vështirë ku hallkat nga prodhuesi tek konsumatori nuk funksionojnë si duhet.

Sipas tyre, çmimi për kilogram i qershisë ka arritur në 20 lekë ndërsa më parë ka qenë 120 lekë. Çmimet e larta të inputeve bujqësore si edhe karburanti, krahas kostove të krahut të punës dhe shpenzimeve

te tjera i ka detyruar fermerët ta lenë qershinë në pemë.

druar tek frutikultura por situata duket e njëjtë dhe fermerët



Dvorani është vetëm një prej fshatrave të Korçës të përçen-

shpeshojnë për mbështetje nga shteti.

“Asgjë nuk vjen vetvetiu, por nëse bëni përpjekje për të, gjërat bëhen dhe kënaqësitë vijnë”, kështu shprehet me krenari Antonion Plaka, 39-vjeçari me origjinë nga Fieri i Shqipërisë, i cili mbërriti në Pistoia, Itali në vitin 1998, kur ishte vetëm 13 vjeç. Historia e familjes së tij nisi kur ai mbërriti në Pistoia dhe ia doli i vetëm të hapte me kalimin e viteve një sërë aktivitetesh tregtare që e kanë bërë simbolin e shitjes së frutave dhe perimet në qytet. Stenda blu e tij “Plaka fruta-perime” njihet nga të gjithë pistoianët pasi ka pushtuar klientët me fruta dhe perime gjithmonë të freskëta dhe cilësore. Nga viti 2018, shqiptari filloi të zgjerojë biznesin e tij duke hapur edhe dy dyqane ushqimore dhe produk-

te tipike. E para në vialë Adua, e dyta në via Metello Gianni.

Asgjë nuk ishte e lehtë por puna e vështirë, në fund, na lejoi të arrijmë këtu. Dhe kjo është shtytja më e mirë për të vazhduar rritjen.

Historia e Antonion Plakës fillon me vendimin e dhimbshëm për të lënë shtëpinë dhe prindërit e tij në Fier ku ata ende jetojnë për t'u bashkuar me vëllain dhe kushërinë e tij të madh që tashmë jetonin në Pistoia. Qytet në të cilin komuniteti shqiptar është i huaji i parë për nga numri i banorëve dhe që është afër 9% e numrit

“Asgjë nuk vjen vetvetiu”, 39 vjeçari nga Fieri “kap” tregun e fruta perimeve në qytetin italian



të përgjithshëm të qytetarëve. Në vitin 1998 isha 13 por të

vendi im u copëtua nga një luftë e tmerrshme civile. Nuk kishte punë, nuk kishte paqe, nuk kishte të ardhme. Pikërisht në atë moment vendosa të vij në Itali për të kërkuar pasurinë time dhe për të jetuar jetën time, për atë që ndjeja në të vërtetë se isha. Kështu që hipa në anija dhe u bashkoav me një pjesë të familjes sime. Në atë kohë kushëriri im kishte tashmë një stendë frutaperimesh në via Clemente IX, ku punonte edhe vëllai im, i cili është nëntë vjet më i madh se unë. Aty nisa të hidhja hapat e parë në industri. Sigurisht, nuk

ishte e lehtë. Ditët tona fillojnë në tre e gjysmë të mëngjesit kur bie alarmi. Çdo ditë, edhe sot, shkoj në tregun gjeneral Novoli për t'u mbushur me fruta dhe perime. Shtatë ditë në javë, me ditët që vazhdojnë deri në mbremje, me përjashtim të së dielës kur punojmë gjysmë dite.

Dimër, verë, i ftohtë, shi, diell përvëlues. Asgjë nuk e ndalon familjen Plaka, e cila pas stendës së parë në via Clemente IX ka hapur edhe atë në via Spartitoio. Megjithatë, në një moment të caktuar lindi nevoja për të zgjeruar biznesin dhe për t'u fokusuar në diçka tjetër.

Kur vendosa ta bëj këtë kërçim, qoftë edhe pak në errësirë mendova për vajzat e mia, të



KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR



SHOQATAT ANETARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI PËR ÇDO SIPERMARRËS

KREDI E SHPEJTË ME NORMA KONKURRUESE

deri në

7 MILIONË
Lekë



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

KËNDI I EKSPERTIT

Kalendari bujqësor, muaji korrik 2022

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Pamja e qiellit gjatë muajit korrik 2022

Më 13 korrik - Hëna e plotë, Superhëna. Hëna do të jetë e

në orën 20:01 pasdite dhe dita më e gjatë do të jetë 1 korriku me 15 orë 7 minuta ditë, lindja e diellit do të jetë në orën 5:11 e mëngjesit dhe perëndimi i

Parashikimi i motit për muajin korrik 2022 në Tiranë (Zona bregdetare)

Table with columns: Dt., Temperatura e ajrit °C (U, L), Temp. reale qe ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë, Drejtimi), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, Simboli. Rows 1-31.

Parashikimi i motit për korrik 2022 në Korçë (Zona e ftohtë)

Table with columns: Dt., Temperatura e ajrit °C (U, L), Temp. reale qe ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë, Drejtimi), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, Simboli. Rows 1-31.

vendosur në anën e kundërt të Tokës nga Dielli dhe faqja e saj do të jetë plotësisht e ndriçuar. Kjo fazë do të ndodhë në orën 18:38 UTC. Kjo hënë e plotë njihej nga fiset e hershme vendase amerikane si Hëna e Drrerit sepse dreri mashkull do të fillonte të rriste brirët e tij të rinj në këtë kohë të vitit. Kjo hënë ka qenë e njohur edhe si Hëna e Bubullimave dhe Hëna e Barit. Kjo është gjithashtu e dyta nga tre superhënat për vitin 2022. Hëna do të jetë në distancë më të afërt me Tokën dhe mund të duket pak më e madhe dhe më e ndritshme se zakonisht.

Më 28 korrik - Hëna e re. Hëna do të vendoset në të njëjtën anë të Tokës me Diellin dhe nuk do të jetë e dukshme në qiellin e natës. Kjo fazë do të ndodhë në orën 17:55 UTC. Kjo është koha më e mirë e muajit për të vëzhguar objektet të zbehta si galaktikat dhe grupimet e yjeve, sepse nuk ka dritë të hënës që të ndërhyjë.

Më 28 korrik 29 - Dushi meteorësh Delta Aquarids. Delta Aquarids është një shi mesatar që mund të prodhojë deri në 20 meteorë në orë në kulmin e tij. Ai prodhohet nga mbeturinat e lëna pas nga kometat Marsden dhe Kracht. Dushi zgjat çdo vit nga 12 korriku deri më 23 gusht. Piku i tij këtë vit është natën e 28 korrikut dhe mëngjesin e 29 korrikut. Ky është një vit i mrekullueshëm për këtë dush, sepse hëna e re do të thotë qiej të errët dhe shfaqja do të jetë e shkëlqyer. Shikimi më i mirë do të jetë nga një vend i errët pas mesnate. Meteorët do të rrezatojnë nga yjësia e Ujorit, por mund të shfaqen kudo në qiell.

Treguesit mesatarë klimatike gjatë muajit korrik 2022

Table with columns: Treguesit, Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër, Dibër, Gjirokastrë. Rows: Temperatura e ajrit (Mesatare, Maksimale, Minimale), Më e larta gjatë viteve, Më e ulta gjatë viteve, Numuri i ditëve me temperaturë mbi +18°C, Numuri i ditëve me temperaturë mbi +30°C, Era (Shpejtësia e erës, Temperatura e erës), Reshjet (Shiu), Sasia rekord e shiut gjatë një dite, Dëborë, Lagështia e ajrit, Shikueshmëria, Mbulimi i qiellit me re, UV index, Ditë me Diell, Gjatësia e ditës, Vlerësimi i muajit.

Parashikimi i motit për muajin korrik 2022

Shprehja që në përgjithësi përshkruan më së miri motin në korrik është e këndshme dhe me diell. Korriku në Tiranë është i ndikuar nga klima bregdetare mesdhetare. Korriku është një nga muajt më të mirë të vitit për sa i përket motit në Tiranë. Kur udhëtoni për në Tiranë në korrik, mund të prisni: herë pas here reshje shiu, herë pas here stuhi dhe mot tropikale. Gjatë gjithë korrikut sigurohuni që të përgatiteni për valën e të nxehtë me mot tropikal dhe temperaturë mesatare mbi 33°C. Zakonisht java e dytë është më e nxehta në korrik, por mbani mend se mund të ketë stuhi dhe shi. Ngjarjet e motit që mund të ndodhin gjatë udhëtimit për në Tiranë: 6 herë Shi, 7 herë stuhi, por mund të jeni të qetë për Reshjet. Vitet

e fundit, mesatarisht, vetëm 6 ditë ishte me shi. Tirana në muajin korrik përjeton ditë të nxehta me paksa vranësira. Zakonisht temperatura luhetet rreth 31°C dhe era është fllad i lehtë.

Temperaturat e larta ditore do të rriten me 2°C, nga 30°C në 32°C, rrallë duke rënë nën 26°C ose duke kaluar mbi 36°C.

Temperaturat e ulëta ditore do të rriten me 1°C, nga 17°C në 18°C, rrallë duke rënë nën 13°C ose duke kaluar 21°C. Temperatura më e lartë mesatare ditore e ulët do të jetë 18°C më 31 korrik.

Për referencë, më 3 gusht, dita më e nxehtë e vitit, temperaturat në Tiranë zakonisht variojnë nga 18°C në 32°C, ndërsa më 4 janar, dita më e ftohtë e vitit, ato shkojnë nga 0°C në 11°C.

Zhvillimi i reve Muaji korrik në Tiranë do

Kalendari, fazat e hënës dhe shënjat astrologjike për muajin korrik 2022

Table with columns: Dt., Dita, Dita e Vitit, Dielli (Lind, Perëndon), Zgjatja e ditës, Hëna (Lind, Perëndon), Fazat e Hënës (Faza, %, Dita), Shënjat Astrologjike. Rows 1-31.

të përrjetojë në thelb mbulim të vazhdueshëm me re, me përqindjen e kohës që qielli është me vranësira ose kryesisht me re, të mbetet rreth 11% gjatë gjithë muajit. Mundësia më e ulët për kushte me vranësira ose kryesisht vranësira është 9% më 21 korrik. Dita më e kthjellët e muajit është 21 korriku, me kushte të kthjellëta, kryesisht të kthjellëta ose pjesërisht me vranësira në 91% të rasteve. Për referencë, më 7 dhjetor, dita më e vrenjtur e vitit,

shansi i kushteve të mbuluara me re ose më së shumti me re është 55%, ndërsa më 21 korrik, dita më e qartë e vitit, mundësia e qiellit të qartë, është 91%. Drita e Diellit Në korrik, gjatësia e ditës gradualisht fillon të zvogëlohet me rreth 40 minuta. Dita më e shkurtër do të jetë 31 korriku dhe ofron 14 orë 27 minuta dritë dite, lindja e diellit do të jetë në orën 5:34 e mëngjesit dhe perëndimi i diellit do të jetë

diellit do të jetë në orën 20:19. Për një udhëtar, numri i orëve të diellit është shumë i rëndësishëm. Ky muaj ofron mesatarisht 15 orë dite. Për referencë, më 21 qershor, dita më e gjatë e vitit, Dielli lind në orën 05:07 dhe perëndon 15 orë, 10 minuta më vonë, në orën 20:17, ndërsa më 21 dhjetor, dita më e shkurtër e vitit, dielli lind në orën 07:03 dhe perëndon 9 orë e 11 minuta më vonë, në orën 16:14. (Vijon në faqen 14)

Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,
BËHET!*



 **CREDINS bank**

www.bankacredins.com

Tel.: +355 4 53 53 000

